

Hyrje në shpjegimin indikativ të Kuranit¹

Nga Didmar Faja

Shpjegimi i Kuranit është një nga disiplinat bazë të Islamit, ngase Kurani është fjala e Zotit dhe si i tillë konsiderohet si burim kryesorë i telogjisë Islame, ligjit Islam, madje dhe gjuhës Arabe. Kjo disiplinë ka lidhje të ngushta gjithashtu dhe me të gjitha disiplinat e tjera Islame. Pra, analiza adekuate dhe kuptimi i saktë i saj ndikon fuqishëm në botëkumtimin dhe praktikën e duhur Islame.

Për shekuj me radhë, studiuesit e shpjegimit (*tefsir*) të Kuranit kanë përdorur në përgjithësi tre metoda themelore të shpjegimit (*tefsir*) të tij:

1. Metoda përcjellëse (*tefsir bir-rivajeh*), e cila bazohet tek transmetimet e traditës profetike të Hz. Muhammedit (a.s.), të cilat quhen hadithe.
2. Metoda logjike (*tefsir bir-re'j*), e cila bazohet në përdorimin e arsyes së shëndoshë dhe hulumtimit (*ixhtihad*).
3. Metoda indikative (*tefsir ishari*), e cila bazohet në shpjegimin e Kuranit përtej kuptimit të tij të jashtëm.² Shpeshherë përmendet dhe si shpjegimi sufi (*tefsir el-sufi*).

Megjithëse metoda indikative e shpjegimit të Kuranit, e përdorur më shumë nga dijetarët e dimensioneve të brendshme shpirtërore të Islamit (*ehl el-tasavvuf*), ka qene shpesh e shikuar me skepticizëm dhe madje është hedhur poshtë nga disa studiues, të cilët janë shprehur, se ajo është bazuar thjeshtë në opinionet e mistikëve.³ Sidoqoftë, sipas imamit të njohur dhe mjeshtrit të disiplinave të njohura Islame, Ebu Hamid Gazali (v. 1111)⁴, përmendet se metoda indikative e shpjegimit të Kuranit ndihmon në arritje të larta shpirtërore. Në librin e tij, *Xhevahir El-Kur'an ve Duraruh*, Gazali i ka kushtuar një kapitull të tërë dobisë së përdorimit të metodës indikative në Kuran, ku përmend: “Ta dini se çdo dobi gjëndet përtej këtyre indikacioneve (të Kuranit), prandaj dhe janë përdorur, në mënyrë që ju përmes tyre ta dini përkufizimin e rrugës së kuptimeve shpirtërore të botës së padukshme, nëpërmjet fjalëve të njohura që përdoren shpesh. Kështu që

¹ Artikulli është shkruar për herë të parë në anglisht në vitin 2013 dhe është përkthyer dhe reduktuar vetë nga autori në gjuhën shqipe në vitin 2022. Ky pjesë është shkëputur nga një shkrim më i detajuar, në të cilin kam rrallitur pikat kyce që ndihmojnë në zhvillimin shpirtëror të individit nga kaptina Jusuf, e Kuranit famëlartë, ku pikë referimit është përdorur komentimi i kaptinës Jusuf nga libri “Ruh el-Bejan”, i dijetarit të famshëm osman, Ismail Hakki Bursevi (v.1715).

² Ahmad Von Denfer: *Ulum al-Qurān, An introduction to the sciences of the Quran*, Leicestershire, 2007, fq. 124-32.

³ Xhelaleddin El-Sujuti, : *El-Itkan fi Ulum el-Kur'an*, Bejrut, 1973, vëll. II, fq.174.

⁴ Dijetar klasik mysliman, mbrojtës i tefsirit sufi. Mund të shikosh në gjuhën angleze librin e Kristin Z. Sands, *Sufi Commentaries on the Qur'an in classical Islam*, New York, 2006, fq. 60.

dyert e zbulimit të kuptimeve të Kuranit mund të hapen (për ju) dhe metodat e thellimit në detet e tyre mund të njihen.”⁵

Për disa persona të cilët kërkojnë pasurimin shpirtëror, të kuptuarit e Kuranit, duke përdorur vetëm shpjegimin rrëfyes dhe logjik (*rivajeh ve dirajeh*), mund të mos jetë i mjaftueshëm për të na çuar tek kuptimet e brendshme të ajeteve. Imam Gazaliu u shpjegon në mënyrë të detajuar lexuesve: “Unë nuk mendoj, se ju do të arrini sukses (në kërkim të të fshehtave të Kuranit) nëse ju vazhdoni me kokëfortësi me opinionin dhe intelektin tuaj. Si mund ta kuptoni ju këtë, kur ju nuk kuptoni gjuhën e gjendjeve shpirtërore (*lisan el-ahval*)?”⁶

Një pyetje mund të ngrihet me plot të drejtë: Cilët janë personat kompetetë në zhbërthimin e kuptimeve të brendshme dhe hollësitë indikative të përdorura në Kuran?

Sipas shpjeguesit të famshëm të Kuranit, Ahmed Ibn Axhibeh (v. 1809), përmendet se disa njerëz që arrijnë afërsinë me Zotin (*kurb*), arrijnë të ngrihen në një gjendje shpirtërore më të larta se shumë të tjerë, deri aty sa ata mund të posedojnë një përvojë shpirtërore dhe njohuri që nuk iu janë dhënë çdokujt. Këta janë të vetmit, që mund të shtjellojnë kuptimet e brendshme të ajeteve. Pra, këta njerëz të devotshëm nuk arrijnë lartësimin shpirtëror vetëm nga dituritë fetare, por përveç përmbushjes së obligimeve fetare, ata dedikohen me sinqeritet dhe devotshmëri në afrimin e tyre me Allahun përmes meditimit (*tefekkur*), përmendjes së Allahut, disiplinës së egos, etj.

Duke iu referuar librit “*Lataif El-Minan*”⁷, Ibn Axhibeh konstaton në parathënien e tefsirit të tij, “*Bahr el-Medid fi tefsir el-Kur'an el-Mexhid*”: “Ta dini se shtjellimet e këtyre shpirtmirëve, ose shtjelluesave sufijë, nuk i referohen kuptimeve të dukshme të ajeteve, sepse kuptimi i dukshëm është më i lehtë të arrihet, duke pasur parasysh (rrethanat dhe shkaqet) e shpalljes së Kuranit dhe shprehjet e ndryshme (kuptimi i të cilave arrihet përmes njohurive të gjuhës arabe). Ndërsa kuptimi i brendshëm (ezoterik) i ajeteve të Kuranit ose hadithit është i kuptueshëm vetëm nga ai, të cilit Zoti është i kënaqur me zemrën e tij”⁸.

Shkaku që e bën shpjegimin indikativ të veçantë, është aftësia e dijetarëve sufijë të shkruajnë komentimin e Kuranit duke përmendur jo vetëm metodën indikative të shtjellimit, por gjithashtu duke përfshirë dhe dy metodat e tjera: përcjellëse dhe logjike (*rivajeh ve dirajeh*)⁹. Megjithatë, kjo metodë e të shkruarit nuk është zbatuar nga të gjithë shpjeguesit sufijë. Ibn Axhibeh citon nga libri i tefsirit të Kuranit të Shejh Ahmed Ez-zerruk: “Pikëpamja sufiste (që ka të bëjë me komentimin e

⁵ Ebu Hamid Gazali: *The jewels of the Qur'an*, përkthyer nga arabishtja në Anglisht nga Muhammad Abul Quasem, Kuala Lumpur, 1977, fq. 62.

⁶ Ebu Hamid Gazali: *Javahirul-Kur'an ve Dururuh*, Darul-Afak el-Xhedideh, 1983, fq. 33.

⁷ Emri i plotë i librit është: *Lataiful-Minen ve el-Ahlak fi Vuxhub el-Tahadduth bi Ni'metil-lahi ala el-Itlak*, që shpesh përmendet si: *El-Minen El-Kubra*, shkruar nga Imam El-Muvahib Abdul-Veh-hab El-Sha'rani, shtypur nga Darul-Kutub el-Ilmij-jeh, Bejrut, 2010.

⁸ Ahmed Ibn Axhibeh: *El-Bahrul-Medid fi tefsiril-Kur'an el-Mexhid*, Darul-Kutub El-Ilmij-jeh, Bejrut, 2010, vëll.1, fq.16-7.

⁹ Nga metodat e shpjegimit të Kur'anit që përmenden në fillim të artikullit.

Kuranit) përfshin shtjellim më të gjërë se sa shtjellimi i komentuesave (të zakonshëm të Kuranit), qofshin ata dhe dijetarë të ligjit Islam (*fukaha*) ose të traditës Profetike, Hadithit (*muhaddithun*). Pas përmendjes së rregullave Islame (që nxjerren nga ajetet) dhe kuptimit të drejtpërdrejtë, (dijetari, ose shpjeguesi sufij) shton dhe kuptimin indikativ të ajetit, përndryshe (nëse mohohet kuptimi i drejtpërdrejtë i ajeteve), e kthen shpjeguesin në një person që ndalet vetëm në kuptimin e brendshëm të ajeteve (*batini*), dhe që një i tillë konsiderohet i dalë nga kufijtë e ligjit Islam (sheriatis) dhe sufismit. Zoti e di me se miri!”¹⁰

Shembuj te shpjegimit indikativ në Kur'an

Allahu i Madhëruar, në Kur'anin famëlartë përdor shembuj indikativë, të cilat Ai vetë i ilustron për njerëzimin. P.sh. në suren Ibrahim përmendet: “A nuk ke kuptuar se si All-llahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart, e që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frutin e vet në çdo kohë. Allahu pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe është si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar.”¹¹ Në këto ajete shikohet qartë metoda indikative ose figurative, ku Allahu i Lartmadhëruar krahason pemën e mirë me fjalën e mirë. Gjithashtu, përmendet pema e keqe, e cila koresponдон me fjalën e keqe. Këto janë shembuj indikues të ilustruara vetë nga Allahu. Metoda e ndjekur në këto ajete e fton lexuesin të mendojë më thellë rreth lidhjes së vecorive të pemës së mirë me ato të fjalës së mirë, dhe vecoritë e pemës së keqe me ato të fjalës së keqe. Si rezultat, shemulli indikativ, e fton lexuesin të hyjë më në brendësi të shembujve, duke ia bërë mesazhin më të përshtatshëm në jetën praktike dhe duke i ngulitur më mirë këto shembuj në kujtesën e individit.

Por gjithashtu, në Kur'an ka edhe shprehje ose ajete të pailustruara përmes të cilave kërkohet të arrihet kuptimi i mbrendshëm i tyre. Sa më shumë që lexuesi ta njohi Allahun përmes afrimit me Të, të njohi Kur'anin, traditën Profetike (*sunneh*), dhe lëmitë e ndryshme Islame, aq më i madh është përfitimi i kuptimit të mbrendshëm të tij, gjë që buron nga kuptimi i metodës indikative. Dikush mund të shtrojë pyetjen: A ka argument se Allahu kërkon nga njeriu të kuptojë mbrendësitë e Kur'anit përmes shenjave indikuese? Po. Në suren Al Imran thuhet: “Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për ata që mendojnë.”¹² Në këtë ajet nuk përdoren shembuj të ilustruar dhe nuk jepen detaja se në cilat shenja indikuese të krijimit të tokës dhe të qiejve njeriu duhet të përqendrohet. Pra, kuptohet se njeriu duhet të mendohet dhe të arrijë në një përfundim të paluhatur. Ajeti i lartpërmendur na fton të hulumtojmë në të dhëna shkencore se si janë krijuar toka dhe qiejt. Sipas të dhënave shkencore, i gjithë universi i tërë nuk kanë qenë në formën që është sot. Përmes biliona vitesh, ai është zgjeruar. Dhe sipas të dhënave shkencore, pasi që ai të arrijë pikën kulminante të zgjerimit, ai prap do fillojë të zvogëlohet, derisa të vij fundi i tij, që njihet në Islam si “Dita e Kijametit”. A nuk manifestohen këto dukuri natyrore

¹⁰ Ibn Axihibeh: *El-Bahrul-Medid fi tefsiril-Kur'an el-Mexhid*, fq. 18.

¹¹ Kur'ani (14:24-6).

¹² Ibid. (3:190).

dhe tek individi? Ai është një univers në vehte. Fillimi i tij është një pikë dhe më pas zhvillohet deri kur arrin kulmin e zhvillimit, e më pas dobësohet dhe i vjen vdekja. Pra, dukuritë natyrore përmbajnë shenja indikuese që lidhen ngushtë me natyrën dhe jetën njerëzore. Një meditim i tillë, sado i thjeshtë, e fton njeriun në mbrendësitë e ajeteve, dhe ai, duke dëshmuar këto mrekulli Kur'anore përmes shenjave indikuese, afrohet edhe më tepër me Krijuesin. Afrimi me Krijuesin e bën besimtarin ta adhurojë Allahun më shumë, ta dëshmojë egzistencën e Tij me plot bindje dhe t'i frikësohet dënimit të Tij. Prandaj, në ajetin që vijon në suren Al Imran, Allahu përmend: “(besimtarë të vërtetë) jan ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjtur ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto, lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”¹³

Përfundimi

Në ditët tona, vërehet një rënie ose zbehje e shprehjeve që burojnë nga shembujt alegorikë, indikativ dhe meditues. Një gjë e tillë vërehet jo vetëm në shpjegimin e Kur'anit nga shpjegues dhe oratorë të kohës sonë, por ky fenomen vihet re edhe në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me letërsinë, oratorinë, etj. Rritja e përdorimit të teknologjisë, globalizimi, dhe shkrirja e kulturave në një kulturë të vetme, që ndodhë shpeshherë, kanë lënë gjurmë të konsiderueshme në rënien ose zbehjen e një meditimi cilësorë që rrjell nga komponente indikuese.

Kuptimi i drejtpërdrejtë i ajeteve të Kur'anit dhe përmbushja e rregullava që Allahu kërkon nga njerëzit, nga pikëpamja Islame konsiderohen si të pa evitueshme, ngaqë shumë ajete kanë urdhëra dhe mësim të drejtpërdrejta. Sidoqoftë, kur këndvështrimi mbetet vetëm sipërfaqësor dhe ndalohet vetëm tek rregulli, mund të kufizojë idetë, mendimet, imagjinatën, dhe botën shpirtërore të njeriut, duke e kthyer individin në një person që kufizohet në kuptimin e mbrendshëm të Kur'anit.

Kuptimi i retorikes, shprehjeve figurative dhe indikuese në Kur'an, ndihmon në rritjen e gjëndjes mendore, shpirtërore, meditative dhe mbajtjen në kujtesë të shumë ideve të veçanta. Nëpërmjet shembujve indikues, oratorë dhe shtjellues të ndryshëm shprehin mendimet e tyre komplekse në një formë më të kuptueshme për lexuesin, ose dëgjuesin. Prandaj, dhe shumë dijetarë myslimanë të tefsirit *ishari*, duke përdorur metodën indikative të shpjegimit, kanë shkruar komentime me vëllime të shumta, me shpresë që t'u sjellin dobi të tjerëve në kuptimin e mbrendshëm të Kur'anit të shenjtë.

¹³ Kur'ani (3:191).

Bibliografia

- Denfer, Ahmad Von: *Ulum al-Qur'an, an Introduction to the Sciences of the Quran*, Leicestershire, 2007
- El-Sha'rani, Abdul-Veh-hab: *Lataiful-Minen ve el-Ahlak fi Vuxhub el-Tahadduth bi Ni'metil-lahi ala el-Itlak*, Dar el-Kutub el-Ilmij-jeh, Bejrut, 2010.
- Gazali, Ebu Hamid Muhammed Ibn Muhammed: *Xhevahir el-Kur'an ve Duraruh*, Dar el-Afak el-Xhedideh, 1983
- Gazali, Ebu Hamid Muhammed Ibn Muhammed: *The jewels of the Qur'an*. Përkthyer nga Arabishtja në Anglisht nga Muhammad Abul Quasem, Kuala Lampur, 1977
- Ibn Axhibeh, Ahmad: *Bahr el-Medid fi Tefsir el-Kur'an el-Mexhid*, Dar el-Kutub el-Ilmij-jeh, Bejrut, 2010
- Sands, Kristin Zahra: *Sufi commentaries on the Qur'an in classical Islam*, Routledge, New York, 2006
- Sujuti, Xhelal el-Din: *El-Itqan fi Ulum El-Kur'an*, Beirut, 1973